



qendra e provimeve

MASA

E VËRTETË

E NJOHURIVE

GARAT SHTETËRORE 2015

SHIFRA E NXËNËSIT

SHKOLLA FILLORE

BIOLOGJI

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PIKËVE TË FITUARA

Testin e kontrollloi

Podgoricë, 20.....

UDHËZIM

Të dashur garues,

Testi nga biologjia është paraparë që të punohet për 150 minuta.

Testi detyrimisht duhet zgjidhur me laps kimik (gjatë punës mund ta përdorni lapsin e thjeshtë, mirëpo përgjigjja përfundimtare duhet të jetë e shkruar me laps kimik).

Përgjigjet të cilat nuk janë shkruar qartë ose janë përmirësuar nuk do të vlerësohen, prandaj mendohuni mirë para se të jepni përgjigjen përfundimtare.

Ju dëshirojmë punë të mbarë!

Në detyrat nga 1 deri në 14 rrethoni përgjigjen e saktë

1. Cila organele te qepallorët shërben për tretjen e ushqimit:

- a) bërthama e vogël
- b) vakuola kontraktile
- c) vakuola ushqyese
- d) gryka qelizore

2. Nëse një organizëm është njëqelizor, ushqehet në mënyrë heterotrofe, jeton në mënyrë platonike dhe ka aftësinë e shumëzimit seksual, ai i përket botës:

- a) monere
- b) kafshëve
- c) protistave
- d) kërpudhave
- e) bimëve

3. Përfaqësuesi i flatramembranorëve është:

- a) thnegla
- b) miza
- c) zekthi
- d) këlyshi i dheut

4. Vetia e përbashkët e të gjithë organizmave që radhiten në këmbënyjorët është:

- a) trupin e kanë të mbështjellë me mbështjellësin e fortë nga kitina
- b) kanë sistemin e mbyllur të gjakut
- c) të gjithë janë në zinxhirin ushqyës konsumues të rendit I
- d) kanë sy të përbërë dhe pamje mozaike
- e) marrin frymë me trake

5. Për peshkaqenin e detit janë karakteristike dy nga vetitë e dhëna:

- a) ka pllenim të jashtëm
- b) nuk ka fshikëzën e peshkut
- c) nga çdo anë ka çarje velëzore të mbuluara me kapakun velëzor
- d) ka gojën të vendosur në mënyrë tërthore nga pjesa e epërme e kokës

6. Bimët e rudinave bjeshkore janë karakteristike për:

- a) gjethet në formë të gjembave
- b) gjethet e bardha me qime
- c) formën e jastëkut
- d) lartësinë e madhe të kërcellit

7. Numri i kromozomeve në qelizën vezë të shimpanzesë është:

- a) 23 (XX)
- b) 24 (X)
- c) 48 (XY)
- d) 23 (XY)

8. Çfarë nga ajo që është dhënë nuk i përgjigjet përshkrimit të reflekseve të pakushtëzuara:

- a) ato janë reflekse të lindura
- b) vezullimi është veprim refleksiv i pakushtëzuar
- c) refleksi një herë i kushtëzuar mund të shuhet
- d) këto reflekse përcillen nga një gjeneratë në gjeneratën tjetër

9. Cili nga aktivitetet e dhëna nuk kërkon kontraktion muskolor:

- a) mbajtja e gotës së ujit
- b) adaptimi i syrit në hyrjen në tunelin e errët
- c) lëvizjet e lukthit të mbushur me ushqim
- d) mbartja e valëve zanore nga timpani i veshit në eshtrat dëgjimor

10. Substancat ushqyese të absorbuara nga zorrët në gjak, para se të mbërrijnë me qarkullim të qelizat, patjetër duhet të kalojnë nëpër:

- a) zëmër
- b) mëlçi
- c) lukth
- d) zorrë dymbëdhjetëgjishtore

11. Te popullata e cila jeton në male, krijimi i eritrociteve është më i shpejtë sepse në lartësi mbidetare më të larta është:

- a) temperatura e ajrit më e ulët, dhe kështu nevojiten më shumë eritrocite për shkak të termorregullacionit
- b) sasia më e vogël e oksigjenit, dhe kështu nevojiten më shumë eritrocite për shkak të shkëmbimit të gazrave
- c) shtypja më e ulët atmosferike, prandaj nevojiten më shumë eritrocite për shkak të mbajtjes së homeostazës
- d) rrezatimi më i madh ultraviolet, dhe kështu nevojiten më shumë eritrocite për tu mbrojtur nga rrezatimi

12. Në bazë të përshkrimit të dhënë, vërteto se për çfarë indi është fjala: indi mund të jetë njështrësor dhe shumë shtrësor, kurse qelizat e këtij indi mund të jenë me forma të ndryshme gjeometrike: kubi, cilindri, kuadri.

- a) indi mbështetës
- b) indi i mbulesës
- c) Indi lidhor
- d) Indi muskolor

13. Trurin i mesëm lidh:

- a) barkushen e parë dhe të dytë të trurit
- b) barkushen e dytë dhe të tretë të trurit
- c) barkushen e tretë dhe të katërt të trurit
- d) barkushen e parë dhe të tretë të trurit

14. Çfarë është karakteristike për individin nëse mollëza e syrit është e ndërtuar sipas figurës së paraqitur? Rrethoni përgjigjen e saktë.




figura 1.

figura 2.

figura 3.

- a) Figura 1. – bart syzet me thjerrëza konvekse (me gungë)
- b) Figura 1. – i shikon mirë objektet në afërsi
- c) Figura 2. – një kohë të gjatë i bart syzet me thjerrëza konkave (lugore)
- d) Figura 3. – i bart syzet me thjerrëza konvekse (me gungë)
- e) Figura 3. – i shikon më mirë objektet në largësi

15. Bashkoni komplekset organike të dhëna me indin në përbërjen e të cilit hyjnë, ashtu që në kllapa vendosni shkronjën përkatëse:

Komplekset organike:

- a) oseina
- b) kitina
- c) melanina
- d) glukagoni
- e) miofibrilet
- f)

Indi:

- () lëkura
- () ashti
- () muskuli
- () gjëndrat
- () kutikula

16. Bashkoni funksionet e dhëna me elementet përkatëse të indit të lëkurës, duke vendosur shkronjat përkatëse në kllapa:

Funksionet:

- a) tajitja e jargëve
- b) freskimi
- c) izolatori i nxehtësisë
- d) energjia rezervë
- e) mbrojtja nga rrezet ultraviolette
- f) regjistrimi i ndjenjave

Elementet e indit të lëkurës:

- () mukoza
- () gjëndrat djersore
- () receptorët e lëkurës
- () qelizat pigmentuese
- () shtresa vjamore e indit nënlëkuror

17. Bashkoni format e dhëna të muskujve skeletor me muskujt e njeriut në përbërjen e të cilit hyjnë, ashtu që në kllapa shënoni shkronjën përkatëse:

Forma e muskujve skeletor:

- a) boshtor
- b) pllakor
- c) shiritor
- d) rrethor
- e) lepeze

Muskujt e njeriut:

- () muskujt barkor
- () muskujt e qafës
- () muskujt parallërës
- () muskujt e gojës
- () muskujt e gjoksit

18. Bashkoni aktivitetet e dhëna të kromozomeve me fazat e caktuara të ciklit qelizor, duke vendosur shkronjën përkatëse në kllapa:

Aktivite e kromozomeve:

- a) kromozomet më së shumti të shkurtuar (të kondenzuara)

() Interfaza

- b) çdo kromozom ndahet për së gjati

() Profaza

- c) kromozomet janë të vendosur në qendër të qelizës

() Metafaza

- d) kromozomet janë të grupuar në polet e qelizës

() Anafaza

- e) kromozomet shkurtohen dhe trashen

() Telofaza

- f) kromozomet jenë në formë të pejzave të hollë dhe të padukshme

19. Bashkoni organizmat e dhënë me përshkrimin përkatës, duke vendosur shkronjën gjegjëse në kllapa:






Organizmi:


- a) Tripanosoma
- b) Kandida
- c) Pulmonar
- d) Karolina
- e) Tartufi
- f) Nostok

Përshkrimi:

- () kërpudha ushqyese
- () alga penjzore blu e gjelbër
- () paraziton në gjuhë dhe organet seksuale
- () shkakton sëmundjen e gjumit
- () algë e kuqe dhe e shpeshtë në Detin Adriatik
- () krijohet me simbiozën e algës dhe kërpudhës

20. Plotësoni drejt tabelën e dhënë:

					
Lloji:	Miza	Grethi	Kacabu	Pleshti	Mola
Rendi:					
Numri i flatrave:					
Përshkrimi i flatrave: - të rrezikshme - me luspa - të forta (shëno tipin)					
Aparati gojor për:					



21. Në tabelë shënoni shenjën "+" në vendin gjegjës për çdo shembull të dhënë:


Shembulli	Ngacmim	Përgjigja në ngacmim
Tingujt e ziles për fillimin e orës		
Rrëqethja e lëkurës me rastin e rënies së temperaturës		
Vezullimi i rezeve të dritës në mur		
Tajitja i pështymës me rastin e shikimit të limonit		
Ndjenja e tremës në bark para fillimit të provimit		



22. Në figurën e mëposhtme është dhënë skema e ndërtimit


Emërtoni saktë pjesët e ndërtimit të shënuara në figurë me shkronjat **A - F**:

A _____ **D** _____
B _____ **E** _____
C _____ **F** _____




23. Në figurën e mëposhtme, shkruani në fushat e dhëna shkronjat të cilat u përgjigjen pjesëve të cekura të ndërtimit të peshqve.

A – gjëndra seksuale, **B** – penda e shpinës, **C** – truri, **D** – muskujt, **E** – barku, **F** – zemra, **G** – verzat, **H** – fshikëza e peshkut, **I** – penda nën bishtore, **J** – mëlçia, **K** – veshka, **L** – penda e bishtit, **M** – trungu nervor, **N** – vrima anale, **O** – gryka, **P** - zorra





24. Vërtetoni cili nga pohimet e dhëna është i saktë (S), përkatësisht i pasaktë (P), duke rrethuar shkronjën përkatëse (S ose P).

- | | | |
|---|---|---|
| a) Drithërat janë bimë dikotiledone nga familja e barërave | S | P |
| b) Origano, nana dhe kamamila i përkasin familjes së fluturorëve | S | P |
| c) Likenet shumëzohen seksualisht vetëm në kushtet e volitshme | S | P |
| d) Të gjitha algat silikate janë njëqelizore | S | P |
| e) Vrugu është kërpudhë pejzore e cila shkakton fermentimin | S | P |
| f) Volvoksi është qepallor kolonial me njësi në masën xhelatinoze | S | P |
| g) Bakteret blu në të gjelbra janë organizma autotrof nga bota
Monera | S | P |
| h) Gjeneracioni dominant te myshqet është gametofiti | S | P |
| i) Boçat mashkullore dhe femërore te halorët gjithmonë gjinden
në të njëjtën bimë | S | P |
| j) Të gjitha monokotilet kanë farë dhe frutë | S | P |




25. Radhitni drejt fazat e ciklit të zhvillimit të meduzës duke filluar nga veza e fekunduar:




26. Radhitni drejt pjesët e syrit nëpër të cilat kalon rrezja e dritës, e cila bart imazhin e objektit që e shikojmë, deri te fusha e receptorit.

A – thjerrëza e syrit; **B** – njolla e verdhë; **C** – trupi qelqor; **D** - kornea; **E** - bebëza.




27. Radhitni drejt fazat zhvillimore të bretkosës:

A – fulterëza me verëza të jashtme, **B** – veza e fekunduar, **C** – zhvillimi i këmbëve të prapme, **D** – humbja e bishtit, **E** – zhvillimi i këmbëve të përparme




28. Radhitni drejt pjesët e boshtit kurrizor, duke filluar nga pjesa më e epërme në trup deri te më e poshtmjaja:

A – pjesa ijore, **B** – pjesa e qafës, **C** – pjesa e bishtit, **D** – pjesa kërbishtore, **E** - pjesa e gjoksit



29. Radhitni vetitë e dhëna të gjarpërinjve në varësi nga ajo nëse i karakterizojnë helmuesit ose johelmuesit, duke shkruar shkronjat përkatëse në diagramin e Venit, kini parasysh edhe zonat që përputhen (vetitë e përbashkëta).

A – koka në formë të vezës, **B** – prania e dhëmbëve të zbrazët, **C** – grabitqarët (mishngrënësit), **D** – koka në formë të trekëndëshit, **E** – mungesa e kockës së kraharorit, **F** – zhvillimi i dobët i shqisës së dëgjimit, **G** – qafa e patheksuar



30. Gjatë ndeshjes së hendbollit lojtari ka vënë re rastin e volitshëm dhe në sekondat e fundit të lojës e ka gjuajtur topin në gol dhe ka shënuar duke i mundur ekipit të vet fitoren. Gjatë kësaj kohe në trupin e tij kanë ndodhur procese të caktuar. Përgjigjuni në pyetjet:

a) Kur e ka vënë re lojtari rastin për gol, ky informacion me nervin e syrit është përcjellë nga syri në cilën pjesë të trurit?


b) Cili tip i fijeve nervore e ka përcjellë këtë informacion deri në tru?

c) Duke marr parasysh reagimin e shpejtë, që ka ndodhur pas vendimit të lojtarit që ta gjuaj topin, a është lëvizja e tij e dorës me rastin e drejtimit të topit në gol një lloj i veprimit reflektiv dhe përse?

d) Në cilën pjesë të trurit ka ndodhur vendimi që lojtari ta gjuaj topin?

e) Nga cila qendër nervore në tru ka ardhur pulsi nervor për lëvizjen e dorës së tij dhe ku gjendet ai?

31. Në skemën e dhënë të qarkullimit të gjakut, 2 shigjeta nuk tregojnë drejtimin e saktë të qarkullimit të gjakut nëpër trupin e njeriut. Gjeni dhe rrethoni 2 shigjetat të cilat duhet ta ndryshojnë drejtimin, në mënyrë që qarkullimi i gjakut të funksionojë normalisht.




32. Varësisht nga tipi i ndryshimit nëpër të cilin kalojnë substancat ushqyese në procesin e tretjes, shënoni shkronjën përkatëse mbi vijat e zbrazëta më poshtë.

- Efekti i enzimeve të pankreasit
- Përzierja dhe zhvendosja e ushqimit me lëvizjet e zorrës së hollë
- Efekti i tëmbëlit në zbërthimin e yndyrës në pikat e imta të yndyrës
- Shkatërrimi i baktereve nga ushqimi me acidin klorhidrik nga lukthi
- Efekti i enzimeve të lëngut të zorrëve të mukozës së zorrës së hollë në substancat ushqyese në zorrë
- Efekti i enzimeve nga pshtyma në zbërthimin e molekulave të ndërlikuara në sheqerna të thjeshta

Ndryshimet mekanike: _____

Ndryshimet kimike: _____

33. Figura paraqet ndërtimin e brendshëm të ndonjë organizmi. Shiko figurën dhe përgjigju:



a) Cilën kafshë e paraqet figura? _____


b) Emëroje pjesën e trupit që është shënuar me numrin 1 në figurë.

c) Sistemin nervor të kësaj kafshe e përbën _____ nga i cili në pjesën anësore dalin nervat.

d) Përgjigjja nga pyetja c) në figurë është shënuar me numrin: _____



34. Trupi i njeriut e rregullon nivelin e sheqerit (glukozës) në gjak me ndihmën e hormoneve. Homeostaza (baraspesha) në organizmin e shëndetshëm arrihet me mbajtjen e nivelit të sheqerit në gjak në rreth 90 mg sheqer/100 ml gjak. Studioje figurën dhe përgjigju në pyetjet (a – f).



a. Emëroji hormonet të cilat në figurë janë shënuar me shkronjat **X** dhe **Y**.
 hormoni **X**: _____ hormoni **Y**: _____

b. Përfundoje skemën e cila tregon mbajtjen e homeostazës, ashtu që në drejtkëndëshat e zbrazët në figurë shkruaj të dhënat përkatëse për ndryshimin e nivelit të sheqerit në gjak.

c. Si quhet gjëndra e cila tajon hormone që marrin pjesë në procesin e dhënë?

d. Çfarë e stimulon (e vë në lëvizje) gjëndrën nga pyetja **c.** që në gjak të tajoj hormonet e rëndësishme për mbajtjen e homeostazës së paraqitur?


e. Glukoza nga gjaku hyn në qeliza dhe zërthehet. Në cilat organele zhvillohet pjesa energjetike më efikase e atij zbërthimit?

f. Nëse gjëndra nga pyetja c. nuk tajit hormone të mjaftueshme X, a thua se me disa hormone të hipofizës, me mekanizmin e lidhjes së kthyeshme të ndikohet në punën e kësaj gjëndre dhe rivendosjen e homeostazës?

35. Zgjidhni drejt asociacionin, ashtu që në fund të fitoni emrin e një organi bitor:

A	B	C
biberi	dhëmbët	najloni
zalli	gjilpëra	letra
kafja	Thur me grepa	mbeturinat

36. Në rrjetin e dhënë të ushqimit ka ardhur deri zhdukja e organizmit të shënuar me shkronjën A. Përgjigjuni në pyetjet (a – d).



a) Si do të ndryshojë numri i organizmit **F**?

b) A do të ndikojë ajo (dhe si) në numrin e organizmit **E**? Jepni sqarimin.

c) Cili nga organizmat tjerë në rrjetë janë konsumator të **rendit I**?

d) Cili nga organizmat është hallka e fundit në rrjetin e ushqimit?



